



**Procesverbal i Dëgjimeve për
Buxhetin
e vitit 2022 dhe Kornizën
Afatmesme Buxhetore (KAB)
2022-2024
në
Hoçë të Vogël**

INFORMATË RRETH NJOFTIMEVE

Njoftimi për organizimin e dëgjimeve buxhetore për buxhetin e vitit 2022 dhe KAB-in për vitet 2022-2024, u publikua me datë: 17.06.2021 në ueb faqen e komunës së Rahovecit, në të dy gjuhët, në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2021/06/Kalendari-i-degjimeve-buxhetore-per-Buxhetin-e-vitet-2022-dhe-Korniza-Afatmesme-Buxhetore-KAB-te-Komunes-se-Rahovecit-per-vitet-2022-2024.pdf> dhe <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2021/06/Raspored-Javnih-Rasprava-za-Budzet-i-Srednjorocni-Okvir-Budzeta-Opstine-Orahovac-za-2022-2024.pdf> në harmoni me afatet ligjore që i përcakton Udhëzimi Administrativ, si vijon:

*Në mbështetje të nenit 68, paragrafi 68.1 i Ligjit Nr.03L-40 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 17 dhe nenit 18 paragrafi 1, pika 1.7, të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, të datës: 29.03.2017, nenit 6 pika 1.3, i Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimet Publike në Komunë, Rregullores Komunale për Transparencë me Nr. Prot. 2697, njoftojmë se nga data: **06.07.2021** deri me datë: **16.07.2021** nën organizimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) do të organizohen pesëmbëdhjetë (15) dëgjime publike buxhetore me qytetarë, për planifikimin e buxhetit për vitin 2022 dhe KAB-in për vitet 2022-2024.*

Me qëllim të rritjes së nivelit të transparencës e llogaridhënies dhe për t'i mbajtur sa më të informuar banorët e komunës së Rahovecit, rreth orarit dhe vendit të mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, janë bërë me kohë planifikimet dhe është publikuar me kohë kalendari i dëgjimeve buxhetore për pesëmbëdhjetë (15) dëgjimet buxhetore në vendbanimet e komunës së Rahovecit në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2021/06/Kalendari-i-degjimeve-buxhetore-per-Buxhetin-e-vitet-2022-dhe-Korniza-Afatmesme-Buxhetore-KAB-te-Komunes-se-Rahovecit-per-vitet-2022-2024.pdf> më datë: 17.06.2021.

Poashtu, bazuar në afatet ligjore janë njoftuar me kohë banorët e secilit vendbanim rreth mbajtjes së dëgjimeve me anë të publikimit të secilit njoftim veç e veç, për secilin vendbanim, në ueb faqe të komunës, shtatë ditë para mbajtjes së dëgjimit në atë vendbanim.

Njoftimi për mbajtjen e dëgjimit buxhetor me banorë të fshatrave Hoçë e Vogël dhe Brestoc u publikua më datë: 14.07.2021 në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2021/07/Njoftim-per-degjim-publik-per-buxhetin-e-vitet-2022-dhe-KAB-in-2022-2024-me-banor-te-fshatit-Krushe-e-Madhe-Celine-Nagavc-Hoce-e-Vogel-dhe-Brestoc.pdf>.

Njoftimet përveç që janë publikuar në uebfaqe të komunës, në Platformën për Konsultime Publike, në rrjetin social Facebook, njoftimet u janë dërguar edhe kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane përmes rrjeteve sociale Viber dhe WhatsApp.

DËGJIMI PUBLIK NË HOÇË TË VOGËL

Dëgjimi publik me banorë të fshatrave **Hoçë e Vogël** dhe **Brestoc**, i planifikuar të mbahet me datë 16.07.2021 me fillim në orën: 20:00 nuk u mbajt. Edhe pse njoftimi u bë kohë nuk pati banorë pjesëmarrës, pos anëtarëve të KPF-së dhe zyrtarëve komunal

Blerta Gashi

*Zyrtare përgjegjëse për koordinimin e dëgjimeve,
konsultimeve dhe takimeve publike*

Rahovec,
gusht 2021